

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Duke pasur parasysh parimet, vlerat dhe përgjegjësitë institucionale të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe ligjet tjera relevante;

Të vendosur për të respektuar, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve të garantuara me Kushtetutë:

Duke respektuar parimet e zgjedhjeve të lira dhe të drejta, efektivitetin në trajtimin dhe zgjidhjen efikase të shkeljeve dhe rasteve në lidhje me zgjedhjet, si dhe vlerat demokratike të Republikës së Kosovës, institucionet në vijim:

1. **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ);**
 2. **Policia e Kosovës (PK);**
 3. **Prokurori i shtetit (PSh);**
 4. **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP);**
 5. **Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) dhe**
 6. **Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)**
- nënshkruajnë këtë:

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

për procesin zgjedhor

Neni 1 – Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi është ngritja e nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit të vazhdueshëm institucional në mes të KQZ, PK, PSH, PZAP, KGjK dhe KPM (më tutje referuar si “palët nënshkruese”), për parandalimin e shkeljeve ligjore si dhe hetimin, ndjekjen dhe gjykimin efikas të të gjitha rasteve që bien ndesh me ligjet, rregullat zgjedhore apo veprat penale kundër të drejtave të votimit në të gjitha fazat e procesit zgjedhor.

Neni 2 – Objektivat

Përmes këtij memorandumi, palët nënshkruese kanë për qëllim të arrijnë këto objektiva:

1. Të parandalojnë shkeljet e ligjeve dhe rregullave zgjedhore si dhe hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e personave që kryejnë vepra penale kundër të drejtave të votimit;
2. Të koordinojnë veprimet ndër-institucionale për të zgjidhur rastet e lidhura me zgjedhjet në mënyrë efikase dhe transparente;

Neni 3 – Obligimet e palëve nënshkruese

Palët nënshkruese angazhohen në mënyrë aktive gjatë të gjitha fazave të procesit zgjedhor që të përmbushin të gjitha obligimet e parapara në këtë memorandum, përfshirë shtojcën e këtij memorandum dhe të venë në dispozicion burime njerëzore dhe kapacitete të mjaftueshme për të përmbushur obligimet që dalin nga ky memorandum.

Neni 4 – Obligimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

1. KQZ do të bashkëpunojë me palët nënshkruese të këtij memorandum, duke ofruar prova materiale për zgjidhjen e rasteve që ndërlidhen me procesin zgjedhor, në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, gjatë të gjitha fazave të procesit zgjedhor.
2. KQZ si bartëse e proceseve zgjedhore në RKS do të organizojë vizita studimore, trajnime me institucionet nënshkruese të këtij memorandum lidhur me të gjitha fazat e procesit zgjedhor duke u bazuar në Ligjin për Zgjedhje, Planin Operacional të KQZ, ndërveprimin me Palët nënshkruese para, gjatë dhe pas çdo procesi zgjedhor.

Neni 5 – Obligimet e Policisë së Kosovës

1. Policia e Kosovës si përgjegjëse kryesore për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike /sigurisë së brendshme të RKS-së, përmes Urdhërit Operativ do të vë në dispozicion kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe teknike me qëllim të parandalimit dhe luftimit të çfarëdo parregullësie që bie në kundërshtim me rendin dhe qetësinë publike apo ligjet e aplikueshme për zgjedhjet, si dhe tentimit për të kryer ose kryerjen e një vepre penale apo çfarëdo veprimi tjetër të kundërligjshëm që mund të dëmtojë mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve në të gjitha fazat e tij nga individ të ndryshëm;
2. PK do të bashkëpunojë dhe koordinojë aktivitetet me prokurorinë e shtetit në mënyrë efektive dhe efektive duke zbatuar procedurat ligjore nga KPPK dhe Planit të Veprimit në mes PK-PSH, duke trajtuar edhe kërkesat e institucioneve të tjera si KQZ, PZAP etj, përfshirë ankesat e qytetarëve lidhur me procesin e zgjedhjeve në të gjitha fazat e tij;
3. PK do të koordinojë me palët nënshkruese aktivitetet për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme me qëllim të garantimit të sigurisë gjatë procesit zgjedhor. Përveç detyrave të saj, PK do të njoftojë menjëherë PSh për procesimin e lëndëve me urgjencë sipas udhëzimeve të PSh, evidentimin e provave të nevojshme për hetim dhe ndjekje të suksesshme e efektive të veprave penale të kryera gjatë procesit zgjedhor në të gjitha fazat e tij.

Neni 6 – Obligimet e Prokurorit të Shtetit

1. Prokuroritë themelore do të dërgojnë në KQZ të gjitha informatat për të gjithë personat e hetuar dhe akuzuar nga Prokuroritë e Kosovës lidhur me procesin e zgjedhjeve;
2. Në mënyrë aktive dhe pa vonesë, PSH do të ndërmarrë aktivitete dhe masa, gjatë të gjitha fazave të procesit zgjedhor, në hetimin dhe ndjekjen penale të gjithë atyre që bien ndesh me dispozitat e Kodit Penal lidhur me veprat penale kundër të drejtave të votimit dhe të gjitha formave tjera të krimit që ndërlidhen me procesin e zgjedhjeve;

3. PSh në bashkëpunim me KQZ do të organizojë trajnime lidhur me veprat penale kundër të drejtave të votimit për të gjithë prokurorët që do të caktohen kujdestarë dhe përgjegjës gjatë procesit zgjedhor;
4. PSh do të angazhojë në punë të gjithë Kryeprokurorët dhe prokurorët e Prokurorive themelore së bashku me personelin tjetër mbështetës në ditën e zgjedhjeve që të punojnë njëjtë me orar sikurse gjatë ditëve tjera të punës.

Neni 7 – Obligimet e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

1. PZAP do t'i koordinojë aktivitetet e saj me KQZ dhe PK, në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, gjatë tërë procesit zgjedhor;
2. Pas marrjes së vendimit përfundimtar në bazë të procedurës së ankimimit, PZAP do të koordinojë aktivitetet me PSh dhe PK në drejtim të identifikimit, njoftimit, dhe ofrimit të ankesave, provave dhe materialeve tjera në dispozicion që kanë të bëjnë me raste të cilat mund të përbëjnë vepër penale.

Neni 8 – Obligimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

1. Të gjitha rastet e ngritura nga prokuroritë e Kosovës lidhur me keqpërdorimet në zgjedhje do të trajtohen nga gjykatat si lëndë me prioritet dhe do të gjykoen pa vonesë.
2. Gjykatat, do të sigurohen në ekzekutimin efikas të gjitha vendimeve lidhur me rastet që janë ngritur si rezultat i procesit të zgjedhjeve.

Neni 9 – Obligimet e Komisionit të Pavarur të Mediave

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), është përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të Ligjit për Zgjedhje në Republikën e Kosovës, me anë të të cilit përcaktohet sjellja e mediave gjatë fushatës zgjedhore;
2. Me qëllim të realizimit të përgjegjësive ligjore në fushën e rregullimit të mediave si dhe përgjegjësive të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, KPM shpreh gatishmërinë që të jetë pjesë e bashkëpunimit me institucionet tjera gjatë procesit zgjedhor, duke respektuar obligimet ligjore të cilat rrjedhin nga Ligji për Zgjedhje;
3. KPM, me qëllim që ofruesve të shërbimeve mediale t'i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore nxjerr Udhëzues për zbatimin e Ligjit për Zgjedhje;
4. KPM është e obliguar që gjatë zhvillimit të fushatës parazgjedhore dhe gjatë heshtjes zgjedhore të përcjellë punën e mediave në lidhje me respektimin e Ligjit për Zgjedhje dhe akteve nënligjore të KPM-së, si dhe të vendosë për ankesat e palëve të sulmuara nga ndonjë përmbajtje programore.

Neni 10 – Obligimet e përbashkëta të palëve nënshkruese

1. Palët nënshkruese do të miratojnë planet e tyre të veprimit dhe sigurohen që planet e tyre të jenë të harmonizuara me këtë memorandum dhe ndërmjet tyre;
2. Palët nënshkruese do të punojnë në mënyrë aktive rreth sensibilizimit të opinionit publik në nivel lokal dhe qendror për pasojat, rreziqet, që ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit të përfshira në Kodin Penal, si dhe shkeljet e tjera të procesit zgjedhor;

3. Palët nënshkruese në vazhdimësi do të grumbullojnë informata dhe do të prodhojnë raporte gjithëpërfshirëse, statistika të përditësuara rreth mbarëvajtjes së procesit zgjedhor dhe veprimeve të institucioneve përkatëse, të cilat prezantohen para opinionit publik;
4. KQZ në bashkëpunim me palët nënshkruese do të ofrojë trajnime për personelin e përfshirë në proceset zgjedhore, në mënyrë që të sigurohen module dhe trajnime unike. Palët nënshkruese obligojnë personelin e tyre që t'i ndjekin këto trajnime.

Neni 11 – Koordinimi i palëve nënshkruese

1. Palët nënshkruese caktojnë nga një koordinator prej personelit të tyre të përhershëm, i cili do të jetë përgjegjës për të koordinuar veprimet institucionale, për të zbatuar dhe vlerësuar zbatimin e këtij memorandum;
2. Përmes koordinatorëve, apo nëse është e nevojshme edhe përmes krerëve të tyre, palët nënshkruese takohen rregullisht për të koordinuar veprimet institucionale, dhe për të përmbushur obligimet dhe objektivat e këtij memorandum;
3. Kryeprokurori i Shtetit emëron Koordinatorin Nacional nga radhët e Prokurorit të Shtetit, i cili kryeson takimet institucionale, dhe është përgjegjës për përgatitjen e raportit gjithëpërfshirës lidhur me rastet penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

Neni 12 – Bashkëpunimi me OJQ-të

Palët nënshkruese bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat për përmbushjen e obligimeve përkatëse që dalin nga ky memorandum dhe informim të publikut;

Neni 13 – Pajtueshmëria

Të gjitha obligimet që rrjedhin nga ky memorandum bashkëpunimi dhe veprimet që ndërmerren duke u thirrur në këtë bashkëpunim duhet të jenë plotësisht në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 14 – Dispozitat përfundimtare

1. Pjesë e këtij memorandum është shtojca Veprimet Institucionale për Koordinim të Vazhdueshëm, që përmban veprimet që secili institucion do të ndërmarrë, përgjatë fazave të ndryshme të procesit zgjedhor, me qëllim të forcimit të bashkëpunimit të vazhdueshëm institucional;
2. Palët nënshkruese përkushtohen që të përmbushin veprimet e parapara në shtojcën Veprimet Institucionale për Koordinim të Vazhdueshëm, me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga ky memorandum;
3. Ky memorandum mund të përcjellet me udhëzues informues dhe të detajuar mbi obligimet ligjore, standardet më të mira, rregullat dhe procedurat kryesore të zgjedhjeve, me qëllim që t'iu ndihmojë prokurorëve, zyrtarëve policor, gjykatësve dhe jurisë në zgjidhjen e lëndëve që kanë të bëjnë me zgjedhjet;

Neni 15 – Hyrja në fuqi dhe tërheqja

1. Ky memorandum bashkëpunimi aktivizohet për çdo cikël të zgjedhjeve menjëherë pas shpalljes së tyre dhe vlen gjatë tërë procesit zgjedhor;
2. Ky memorandum bashkëpunimi mund të ndryshohet apo të përfundojë me marrëveshje nga të gjitha palët nënshkruese apo me kërkesën e ndonjërit institucion, në rast të vlerësimit nga palët nënshkruese se nuk është më tutje i nevojshëm, apo në rast të ndryshimeve të kompetencave institucionale.

DATA: 30.09.2020

VENDI: Prishtinë

Nënshkruar nga:


znj. Valdete Daka
Kryetare e KOZ-së



z. Rashit Qalaj
Drejtor i Përgjithshëm i PK-së



z. Aleksandër Lumezi
Kryeprokuror i Shtetit



znj. Gyltene Sylejmani
Kryetare e PZAP-së



z. Skender Çoçaj
Kryesues i KGJK-së



z. Luan Latifi
Kryeshef Ekzekutiv i KPM-së



SHTOJCA 1: VEPRIMET INSTITUCIONALE PËR KOORDINIM TË PËRHERSHËM

1. Periudha para-zgjedhore (para shpalljes së zgjedhjeve)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa	Prokurori i shtetit	Policia e Kosovës	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Komisioni i Pavarur i Mediave
<ul style="list-style-type: none"> Mirëmbajtja e bazës së të dhënave të personave të cilët kanë bërë shkelje në zgjedhjet e kaluara Sigurimi që subjektet politike i kanë paguar gjokat dhe obligimet e tyre ligjore para certifikimit për zgjedhje 	<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i planit të veprimit për zgjedhje; Mirëmbajtja e bazës së të dhënave të personave të denuar nga PZAP të cilëve iu është ndaluar pjesëmarrja në zgjedhje (si kanidat, personel administrativ); Informimi i KQZ për listen e personave të denuar, dhe subjektet politike të cilat nuk i kanë paguar obligimet financiare të gjobave; Informimi i gjerë i publikut për mënyrat e dorëzimit të ankesave dhe apeleve; Ofrimi i bashkëpunimit me organizatat vëzhguese lidhur me parregullsitë e paraqitura sipas ankesave 	<ul style="list-style-type: none"> Sigurimi për KQZ-në i bazës së të dhënave të fundit të personave të cilët janë nën hetime apo kanë aktakuzë për vepra penale zgjedhore Zhvillimi i planit operacional për shpërndajen e prokurorëve në të gjitha komunat gjatë periudhës zgjedhore; Zhvillimi i planit operacional, alokimi i resurseve dhe buxhetit për ndjekjen e lëndëve të mbetura nga zgjedhjet e kaluara; Vendosja e kontakteve dhe bashkëpunimi me organizatat vëzhguese; Pjesëmarrja në programin orientues të KQZ-së. 	<ul style="list-style-type: none"> Koordinimi, harmonizimi, realizimi dhe vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë për QNR-në, depo qendrore (DQ), depot komunale (DK), KKZ-të dhe QV-të, dhe bashkërendimi dhe planifikimi i të gjitha veprimeve policore në koordinim të ngushtë me KQZ-në; Fillon implementimi i Urdhërit Operativ të PK-së në koordinim me KQZ-në, ku rolin kryesor për sigurinë publike e ka PK; Monitoron dhe përkujdeset për sigurinë e fushatës parazgjedhore, si dhe mban evidencë dhe raporton tek KQZ për tubimet e subjekteve politike; Angazhohet për siguri dhe përcjellje të materialit senzitiv, kontrollim antiterrorist paraprak të lokacioneve të përcaktuara nga KQZ, si : KKZ-ve, DK-ve, QNR-së dhe DQ-ve dhe pastaj merret edhe me sigurimin fizik të tyre pandërprerë. Mbledhja dhe publikimi i statistikave dhe raporteve të ndryshme. 	<ul style="list-style-type: none"> Sigurimi me kohë për institucionet nënshkruese përkatëse i bazës së të dhënave të fundit të personave të cilët janë dënuar apo janë në procedura gjyqësore për vepra penale të zgjedhjeve; Vazhimi i gjykimeve të lëndëve nga zgjedhjet e kaluara; Publikimi i vendimeve të gjykatave, vendosja e tyre me kohë në ueb faqen zyrtare; Informimi i vazhdueshëm i publikut mbi ndëshkimet e shqiptuara nga autoritetet e gjyqësorit ndaj personave të cilët kanë bërë shkelje. 	<ul style="list-style-type: none"> Hartimin e planit të monitorimit të ofruesve të shërbimeve mediale gjatë fushatës zgjedhore dhe heshjes; Nxjerrjen e Udhëzuesit për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, me qëllim që ofruesve të shërbimeve mediale t'i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe heshjes zgjedhore; Dërgimin e Udhëzuesit për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073 tek të gjithë të licensuarit. Qëllimi i dërgimit të udhëzuesit është që ofruesve të shërbimeve mediale t'ju ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore. Nxjerrjen e Udhëzuesve për Ditaret A dhe B për Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve. Ekzistojnë dy forma të termimeve të emetimit politik gjatë fushatës së zgjedhjeve, terminet e emetimit politik pa pagesë dhe me pagesë.

2. Periudha zgjedhore dhe dita e zgjedhjeve (shpallja e zgjedhjeve deri te certifikimi i rezultateve)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa	Prokurori i shtetit	Policia e Kosovës	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Komisioni i Pavarur i Mediave
<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi që personat të cilët kanë kryer vepra penale dhe kanë bërë shkelje zgjedhore të mos përfshihen në administrimin e zgjedhjeve; • Informimi i anëtarëve të komisioneve zgjedhore, këshillave të vendvotimeve, personelit teknik dhe votuesve për dënimet e aplikueshme me Kodin Penal; • Monitorimi i ambientit para zgjedhore, aktivitetete në ditën e zgjedhjeve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Informimi i subjekteve politike, vëzhguesve, dhe votuesve për procedurat e ankesave; • Aplikimi i dënimeve dhe gjobave efektive (proporcionale) kundër subjekteve që kanë kryer shkelje të së njëjtës natyrë; • Informimi i vazhdueshëm i publikut për mënyrën e vendosjes së lëndëve e posaçërisht me vendimet që kanë të bëjnë me shqyrtimin e masave sanksionuese; • Sigurimi që autoritetet e tjera i ndjekin rastet të cilat PZAP referon tek ata; • Koordinimi institucional për informim reciprok lidhur me rastet e paraqitura nga PZAP në institucionet përkatëse; • Njoftimi me kohë i KQZ për përfundimin e procedurave të vendosjes së ankesave dhe apeleve nga PZAP, për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KQZ. 	<ul style="list-style-type: none"> • Vendosija e një, deri në dy prokurorë në të gjitha komunat e Kosovës gjatë ditës së zgjedhjeve; • Koordinimi dhe bashkëpunimi për operacionet zgjedhore me KQZ-në dhe policinë në ditën e zgjedhjeve; • Veprimi i menjëhershëm dhe i saktë në rast se dikush kryen vepra penale zgjedhore. 	<ul style="list-style-type: none"> • Përkujdeset për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor; • Vazhdon në implementim të Urdhërit Operativ të PK-së me masa të sigurisë në të gjitha aspektet si në: QV, KKZ, DQ, DK, QNR; • Bashkërendim efektiv i aktivitetete me Prokurorinë e Shtetit dhe bashkëpunim i plotë me KQZ-në në Dhomën Operative të KQZ-së; • Përcjell dhe siguron materialin senzitiv në Ditën e Zgjedhjeve, para fillimit të procesit zgjedhor dhe pas përfundimit të procesit zgjedhor; • Bashkëpunimi me Prokurorinë në lidhje me incidentet e mundshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • Koordinimi për Prokurorin e Shtetit dhe PZAP në lëndët e mundshme mbi veprat penale zgjedhore; • Veprimi i menjëhershëm dhe fillimi i procedurave për gjykimin e lëndëve të zgjedhjeve; • Prioritizimi dhe gjykimimi i lëndëve të cilat mund të ndikojnë në rezultatet përfundimtare; • Informimi i publikut për vendimet e gjykatave për lëndët e zgjedhjeve, dhe publikimi i vendimeve në ueb faqet zyrtare; • Sigurimi që publiku të ketë qasje në informata që duhet të jenë transparente, pa i shkelur të drejtat për të dhënat personale. 	<ul style="list-style-type: none"> • Angazhimi i gjithë stafit të KPM-së për monitorimin që gjatë zhvillimit të fushatës parazgjedhore dhe gjatë heshtjes zgjedhore të përcjell punën e mediave në lidhje me respektimin e K-reut VIII të Ligjit për Zgjedhjet dhe akteve nënligjore të KPM-së; • Të gjitha pretendimet ankimore dhe të gjeturat e monitorimit për shkelje të mundshme të dispozitave ligjore gjatë procesit zgjedhor, do të trajtohen brenda afatit prej 48 orëve. • Vendimet e KPM-së në lidhje me shkeljet e pretenduara, do të zbatohen menjëherë dhe ankesa kundër këtyre vendimeve (për shkak të efektit të menjëhershëm të këtyre vendimeve) nuk do të pengojë ekzekutimin e tyre, ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 2 pika 2 të Ligjit të KPM-së (vendimet bëhen të plotfuqishme në momentin që iu kumtohen palëve).

3. Periudha pas-zgjedhore (pas certifikimit të rezultateve)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa	Prokurori i shtetit	Policia e Kosovës	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Komisioni i Pavarur i Mediave
<ul style="list-style-type: none"> Ruajtja e materialeve (kutive të votimit, FPR, FRK) bazuar në udhëzimet e PZAP dhe PSH; Ofrimi i provave dhe dëshmi tek prokurorët, gjyqtarët dhe policia, sipas kërkesave; Pjesëmarrja e zyrtarëve të lartë komunal zgjedhor në seanca gjyqësore, në të gjitha komunat e Kosovës; Zhvillimi i fushatave me qëllim të rritjes së besueshmërisë së publikut në trupat menaxhues zgjedhor; Përcjellja e vazhdueshme e çdo lënde në procedurë gjyqësore, dhe mbledhja e të dhënave e raporteve; Kontributi në reformën zgjedhore, dhe shqyrtimi i akteve nënligjore të KQZ-së. 	<ul style="list-style-type: none"> Njoftimi me kohë i KQZ-së lidhur me kutitë e votimit (kodet e qendrave dhe vendvotimet) për të cilat duhet ruajtur materialet zgjedhore; Përcjellja e procedimit të lëndëve të cilat referohen nga PZAP për në PSh, dhe ofrimi i informatave sipas nevojës; Zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të Sekretariatit të PZAP lidhur me legjislacionin e procesit zgjedhor; Zhvillimi i strategjive për informimin e publikut dhe transparencë; Kontributi në reformën zgjedhore, dhe shqyrtimi i rregulloreve të brendshme dhe procedurave. 	<ul style="list-style-type: none"> Ndjekja e vazhdueshme e personave të dyshuar dhe ndaj të cilëve është ngritur aktakuzë; Kërkimi i ndihmës dhe informatave nga trupat menaxhues të zgjedhjeve, sipas nevojës; Udhëzimi i KQZ mbi qendrat dhe vendvotimet për të cilat duhet ruajtur materialet zgjedhore; Koordinimi me organizatat vëzhguese, nëse kanë dëshmitarë apo prova; Kontributi në reformën zgjedhore, dhe shqyrtimi i rregullave të brendshme dhe procedurave. 	<ul style="list-style-type: none"> Transportin nën përcjellje dhe sigurim të PK-së të materialit senzitiv nga QV-të në DK dhe pastaj për në QNR; Sigurimin e QNR-së dhe DQ deri në përfundim të procesit; Përkujdeset për siguri publike edhe pas sipalljes së rezultateve preliminare dhe certifikimit të rezultateve; Ndërmarrja e veprimeve hetimore në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit, në rast se është paraqitur nevojja. 	<ul style="list-style-type: none"> Vendosja dhe përfundimi i të gjitha lëndëve që kanë të bëjnë me zgjedhje, dhe përfundimi i këtyre lëndëve para se të ndodhin zgjedhje të reja; Kontributi në reformën zgjedhore, dhe shqyrtimi i rregullave të brendshme dhe procedurave. 	<ul style="list-style-type: none"> Përfundimi i të gjitha rasteve që kanë të bëjnë me të gjeturat nga monitorimi për shkelje të mundshme nga ofruesit e shërbimeve mediale të dispozitave ligjore gjatë procesit zgjedhor. Shqyrtimin e ankesave që adresohen përmes PZAP; Hartimi i Raportit të monitorimit të Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio-vizuale gjatë fushatës për zgjedhjet.